REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 342, Datë 06.11.2026
MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E "RREGULLORES PËR PROCEDURAT E THJESHTUARA TË LICENCIMIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 2 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*"; neneve 15 dhe 26 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*", miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 3499 prot., datë 05.11.2026, të përgatitur nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 137, datë 18.08.2026 "*Mbi fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores për procedurat e thjeshtuara të licencimit në sektorin e energjisë elektrike*",

Konstatoi se:

- Ligji nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", në nenin 42, pika 2, parashikon zbatimin e procedurave të thjeshtuara të licencimit për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe operimin e impianteve të depozitimit të lidhura në rrjetin e shpërndarjes, si dhe për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Neni 51 i ligjit nr. 59/2026 parashikon një regjim kalimtar për operatorët e impianteve të depozitimit të energjisë elektrike që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë nen. Në zbatim të këtyre parashikimeve, projekt-rregullorja përcakton dispozita të posaçme për paraqitjen dhe shqyrtimin e aplikimeve për licencim të këtyre operatorëve, duke marrë në konsideratë dokumentacionin e administruar më parë pranë ERE-s.
- Projekt-rregullorja përcakton kërkesa të diferencuara dokumentare sipas veprimtarisë përkatëse, duke parashikuar përdorimin e dokumentacionit të vlefshëm të administruar më parë nga ERE, verifikimin e të dhënave në regjistrat publikë dhe shmangien e riparaqitjes së dokumenteve që provojnë të njëjtat të dhëna, me qëllim lehtësimin e procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit për licencim.
- Zbatimi i procedurës së thjeshtuar nuk cenon detyrimin e aplikuesve për përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të licencimit, si dhe respektimin e kërkesave për publikimin e aplikimeve, administrimin dhe shqyrtimin e komenteve dhe kundërshtimeve të palëve të interesuara dhe vendimmarrjen e bordit të ERE-s, në përputhje me ligjin nr. 59/2026.
- Projekt-rregullorja përbëhet nga 19 nene, të organizuara në 5 krerë, dhe 5 anekse, në të cilat përcaktohen formulari i aplikimit dhe dokumentacioni për secilën veprimtari që i nënshtrohet procedurës së thjeshtuar të licencimit. Përpara shqyrtimit për miratim, projekt-akti duhet t'i nënshtrohet procesit të konsultimit me palët e interesuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për shqyrtimin dhe miratimin e *Rregullores për procedurat e thjeshtuara të licencimit në sektorin e energjisë elektrike*" dhe anekseve bashkëlidhur saj.

2. Projekt-rregullorja do t'i nënshtrohet procedurës së konsultimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe procedurat e përcaktuara nga ERE për miratimin e akteve rregullatore.

3. Ngarkohet Grupi i Punës për ndjekjen e procedurës, për kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale lidhur me publikimin dhe konsultimin e projektaktit, administrimin dhe shqyrtimin e komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve të paraqitura, si dhe organizimin e seancave dëgjimore, sipas nevojës, dhe përgatitjen e materialeve për vijimin e procedurës së miratimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s Nr. 342, Datë 06.11.2026

Projekt-RREGULLORE

PËR PROCEDURAT E THJESHTUARA TË LICENCIMIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

KREU I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Kjo rregullore përcakton procedurat dhe dokumentacionin për licencimin me procedurë të thjeshtuar të veprimtarive të përcaktuara në nenin 42, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike".
2. Kjo rregullore përcakton gjithashtu trajtimin e kërkesave për licencimin e operatorëve të impianteve të depozitimit që përfshihen në regjimin kalimtar sipas nenit 51 të ligjit nr. 59/2026.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të neneve 40, 41, 42, 43, 44 dhe 51 të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe në përputhje me ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Procedura e thjeshtuar sipas nenit 42, pika 2, të ligjit nr. 59/2026 zbatohet për:
   a) licencimin e prodhimit të energjisë elektrike nga impiante të lidhura në rrjetin e shpërndarjes;
   b) licencimin e operimit të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike të lidhura në rrjetin e shpërndarjes;
   c) licencimin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Për operatorët e impianteve të depozitimit që përfshihen në regjimin kalimtar të nenit 51 të ligjit nr. 59/2026 zbatohen edhe dispozitat e kreut IV të kësaj rregulloreje.

Neni 4
Zbatimi i procedurës së thjeshtuar

1. Për aplikimet që trajtohen sipas kësaj rregulloreje, ERE shqyrton dokumentacionin e përcaktuar për secilën veprimtari në anekset përkatëse. Dokumentet e paraqitura më parë pranë ERE-s, të cilat janë ende të vlefshme dhe nuk kanë pësuar ndryshime, nuk kërkohen të riparaqiten.

2. ERE verifikon drejtpërdrejt të dhënat që disponohen në regjistrat publikë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kur përmbushja e kërkesave ligjore ose teknike vërtetohet nëpërmjet dokumenteve të lëshuara nga autoritetet kompetente, nuk kërkohet paraqitja e dokumenteve të tjera që vërtetojnë të njëjtat të dhëna.
3. Gjatë shqyrtimit të aplikimit, ERE kërkon dokumentacion plotësues vetëm për të dhënat ose kushtet e licencimit që nuk rezultojnë të provuara nga dokumentacioni i paraqitur apo nga verifikimet e kryera. Kërkesa për plotësimin e dokumentacionit bëhet me shkrim, duke përcaktuar dokumentet që kërkohen dhe arsyet përkatëse.
4. Struktura përgjegjëse e ERE-s administron në dosjen e aplikimit dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi, dokumentet e administruara nga procedurat e mëparshme dhe rezultatet e verifikimeve të kryera.

KREU II – APLIKIMI DHE DOKUMENTACIONI

Neni 5
Paraqitja e aplikimit

1. Aplikimi për licencim paraqitet pranë ERE-s nga personi që kërkon të ushtrojë veprimtarinë, nëpërmjet formularit sipas Aneksit 1 të kësaj rregulloreje.
2. Aplikimi nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor ose personi i autorizuar dhe shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në aneksin përkatës të veprimtarisë.
3. Aplikuesi identifikon dokumentet e paraqitura më parë pranë ERE-s, duke treguar numrin e protokollit ose të dosjes, dhe deklaron ndryshimet e ndodhura në të dhënat përkatëse.
4. Për dokumentet që nuk kërkohen sipas legjislacionit për impiantin ose veprimtarinë përkatëse, aplikuesi deklaron arsyen dhe bazën ligjore të moszbatimit.

Neni 6
Dokumentacioni i përgjithshëm për aplikim

1. Aplikimi shoqërohet me të dhënat për identifikimin dhe regjistrimin ligjor të aplikuesit, përfaqësimin, strukturën e pronësisë ose kontrollit dhe personin përgjegjës për veprimtarinë, sipas formularit dhe aneksit përkatës.
2. Dokumentacioni financiar paraqitet sipas kërkesave të përcaktuara shprehimisht në aneksin e veprimtarisë përkatëse. Raporti i auditimit kërkohet vetëm kur auditimi është i detyrueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7
Dokumentacioni për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për centralet e lidhura në rrjetin e shpërndarjes

Aplikimi për licencimin e prodhimit të energjisë elektrike nga impiante të lidhura në rrjetin e shpërndarjes shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në Aneksin 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Dokumentacioni për licencim në veprimtarinë e operimit të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike të lidhura në rrjetin e shpërndarjes

1. Aplikimi për licencimin e operimit të impianteve të depozitimit të lidhura në rrjetin e shpërndarjes shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në Aneksin 3 të kësaj rregulloreje.
2. Për depozitimin e integruar me prodhimin, kur plotësohen kushtet e nenit 55 të ligjit nr. 59/2026, zbatohet procedura përkatëse e modifikimit të licencës së prodhimit.

Neni 9

Dokumentacioni për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike

1. Aplikimi për licencimin e tregtimit të energjisë elektrike shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në Aneksin 4 të kësaj rregulloreje.
2. Dokumentet e regjistrimit ose autorizimit të aplikuesve në një palë tjetër kontraktuese të Komunitetit të Energjisë vlerësohen në përputhje me nenin 42, pika 3, të ligjit nr. 59/2026.

KREU III – SHQYRTIMI DHE VENDIMMARRJA

Neni 10

Verifikimi paraprak i aplikimit

1. Struktura përgjegjëse për licencimin verifikon aplikimin dhe dokumentacionin e paraqitur sipas kësaj rregulloreje, për të vlerësuar përmbushjen e kërkesave për fillimin e procedurës së licencimit. Gjatë verifikimit merren në konsideratë edhe dokumentet e administruara më parë pranë ERE-s, të cilat janë të vlefshme dhe nuk kanë pësuar ndryshime, si dhe të dhënat e verifikuara në regjistrat publikë.
2. Kur nga verifikimi rezulton se nuk përmbushen kushtet paraprake ligjore për fillimin e procedurës së licencimit, struktura përgjegjëse i propozon Bordit mosfillimin e procedurës, duke evidentuar mangësitë dhe bazën ligjore përkatëse, në përputhje me rregulloren për procedurat dhe afatet e licencimit.
3. Kur aplikimi përmbush kushtet për fillimin e procedurës, por ka mangësi në dokumentacionin plotësues, struktura përgjegjëse i evidenton ato në relacionin që i paraqitet Bordit, sipas nenit 11 të kësaj rregulloreje.
4. Në rastin kur aplikuesi nuk ka kryer pagesën e tarifës së aplikimit, struktura përgjegjëse e ERE-s e njofton me shkrim, brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e regjistrimit të kërkesës, për kryerjen e pagesës brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e njoftimit. Nëse pagesa nuk kryhet brenda këtij afati, struktura përgjegjëse i propozon Bordit mosfillimin e procedurës së licencimit.

Neni 11

Fillimi i procedurës dhe publikimi

1. Pas përfundimit të verifikimit paraprak, struktura përgjegjëse e ERE-s i paraqet Bordit relacionin dhe propozimin për fillimin e procedurës së licencimit, në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje.

2. Bordi vendos për fillimin e procedurës së licencimit. Kur konstatohen mangësi në dokumentacionin plotësues, në vendim përcaktohen dokumentet që duhet të paraqiten nga aplikuesi dhe afati për plotësimin e tyre.
3. ERE publikon njoftimin për aplikimin për licencim brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së aplikimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike". Mënyra e publikimit, përmbajtja e njoftimit dhe afati për paraqitjen e komenteve dhe kundërshtimeve përcaktohen sipas rregullores për procedurat dhe afatet e licencimit.
4. Komentet dhe kundërshtimet e paraqitura nga palët e interesuara administrohen dhe shqyrtohen nga ERE, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 59/2026 dhe dispozitat e rregullores për procedurat dhe afatet e licencimit.

Neni 12

Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimmarrja

1. Pas fillimit të procedurës së licencimit, struktura përgjegjëse e ERE-s shqyrton aplikimin për përmbushjen e kushteve dhe kritereve të licencimit, në përputhje me nenet 40 dhe 41 të ligjit nr. 59/2026, dokumentacionin e përcaktuar në këtë rregullore dhe informacionin e administruar gjatë procedurës.
2. Kur nga shqyrtimi rezulton se përmbushja e kushteve të licencimit nuk provohet nga dokumentacioni i administruar, ERE i kërkon aplikuesit sqarimet ose dokumentacionin plotësues përkatës, duke përcaktuar mangësitë që duhet të plotësohen dhe afatin për paraqitjen e tyre. ERE kryen verifikime pranë operatorëve të sistemit, ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe institucioneve të tjera kompetente, kur këto verifikime nevojiten për vlerësimin e aplikimit.
3. Struktura përgjegjëse për licencimin përgatit relacionin përfundimtar, në të cilin pasqyron rezultatet e shqyrtimit, përmbushjen e kushteve dhe kritereve të licencimit, vlerësimin e komenteve dhe kundërshtimeve të administruara gjatë procedurës, si dhe propozimin për vendimmarrje.
4. Bordi i ERE-s vendos për dhënien ose refuzimin e licencës, në përputhje me ligjin nr. 59/2026 dhe afatet e përcaktuara në të. Vendimi për refuzimin e licencës arsyeton shkaqet konkrete të refuzimit, në përputhje me nenin 44 të ligjit nr. 59/2026.

KREU IV – PROCEDURA E THJESHTUAR PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR SUBJEKTET QË KANË PËRFITUAR NGA REGJIMI KALIMTAR

Neni 13

Fusha e zbatimit të regjimit kalimtar

Dispozitat e këtij kreu zbatohen për operatorët e impianteve të depozitimit të energjisë elektrike që përfshihen në regjimin kalimtar të nenit 51 të ligjit nr. 59/2026 dhe për të cilët ligji parashikon licencimin sipas procedurës së thjeshtuar.

Neni 14

Paraqitja e kërkesës për licencim nga subjektet që kanë përfituar nga regjimi kalimtar

1. Operatori që është përfshirë në regjimin kalimtar paraqet formularin e aplikimit sipas Aneksit 1 dhe dokumentacionin sipas Aneksit 5, duke identifikuar impiantin, statusin e projektit dhe numrin e regjistrimit ose të procedurës së mëparshme pranë ERE-s.
2. Dokumentet e administruara gjatë regjistrimit përdoren për shqyrtimin e licencimit, kur përmbajnë të dhënat e kërkuara, janë të vlefshme dhe nuk kanë pësuar ndryshime.
3. Operatori deklaron me shkrim çdo ndryshim të pronësisë ose të drejtës së përdorimit të impiantit (në referencë të aktit përkatës, sipas rastit, si autorizim, dokumentacion privatizimi etj), kapacitetit, konfigurimit teknik, kushteve të lidhjes me rrjetin dhe statusit të autorizimeve, krahasuar me të dhënat e regjistrimit.

Neni 15

Verifikimi dhe plotësimi i dokumentacionit

1. Struktura përgjegjëse verifikon dosjen e regjistrimit dhe dokumentacionin e aplikimit për licencim, duke evidentuar dokumentet e vlefshme që përdoren pa riparaqitje dhe dokumentet që kërkojnë përditësim.
2. Për impiantet në zhvillim, dokumentacioni i ndërtimit dhe i vënies në operim vlerësohet sipas fazës së realizimit dhe kushteve ligjore për dhënien e licencës. Për impiantet në operim verifikohen dokumentet e testimit, kolaudimit dhe sigurisë teknike, kur kërkohen nga legjislacioni në fuqi.
3. Kërkesa për plotësimin e dokumentacionit identifikon dokumentin që mungon ose të dhënën që duhet përditësuar, si dhe bazën përkatëse ligjore ose rregullatore. Për afatet dhe pasojat procedurale zbatohen nenet 10–12 të kësaj rregulloreje dhe rregullorja e përgjithshme e licencimit.

Neni 16

Shqyrtimi dhe vendimmarrja

1. Procedura e fillimit, publikimit të aplikimit, administrimit të komenteve dhe vendimmarrjes zhvillohet sipas neneve 10–12 të kësaj rregulloreje dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 59/2026.
2. Në relacionin për Bordin, struktura përgjegjëse pasqyron statusin e impiantit sipas nenit 51 të ligjit, dokumentacionin e administruar gjatë regjistrimit, dokumentacionin e plotësuar dhe përmbushjen e kushteve të licencimit.
3. Vendimi për regjistrimin e impiantit nuk paragjykon vendimmarrjen e Bordit për licencimin.

KREU V – DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

Pagesat e aplikimit

Pagesa e aplikimit paguhet sipas vendimit të ERE-s në fuqi. Procedura e thjeshtuar nuk sjell ulje ose përjashtim nga pagesa, përveç rasteve kur kjo parashikohet shprehimisht në aktin përkatës.

Neni 18

Dispozita të tjera

1. Për çështjet që nuk rregullohen shprehimisht në këtë rregullore, zbatohen dispozitat e rregullores së ERE-s për procedurat dhe afatet e licencimit.
2. Në rast mospërputhjeje ndërmjet kësaj rregulloreje dhe ligjit nr. 59/2026, zbatohen dispozitat e ligjit.
3. Anekset 1–5 janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ANEKSI 1 – FORMULARI I APLIKIMIT PËR LICENCIM ME PROCEDURË TË THJESHTUAR

1. Emri i aplikuesit: _____; NUIS ose identifikuesi ligjor: _____; forma juridike: _____; selia dhe adresa: _____ ___.
2. Përfaqësuesi ligjor: _____; personi i autorizuar, nëse ka: _____; numri i telefonit dhe adresa elektronike për njoftime: _____.
3. Veprimtaria për të cilën kërkohet licenca (shënohet njëra): ☐ prodhim i lidhur në shpërndarje; ☐ operim impianti depozitimi i lidhur në shpërndarje; ☐ tregtim; ☐ depozitim sipas regjimit kalimtar të nenit 51 të ligjit nr. 59/2026.
4. Për prodhimin/depozitimin: emërtimi i impiantit: _____; vendndodhja: _____; burimi/teknologjia: _____; fuqia nominale MW: _____; kapaciteti MWh (për depozitimin): _____; operatori i rrjetit: _____; pika e lidhjes: _____.
5. Për tregtimin: tregjet në të cilat synohet ushtrimi i veprimtarisë: _____; personi përgjegjës për transaksionet: _____.
6. Për regjimin kalimtar: numri dhe data e regjistrimit/dosjes së administruar nga ERE: _____; statusi i impiantit (në zhvillim / në operim): _____.
7. Dokumentet që i bashkëlidhen aplikimit: _____. Dokumentet e administruara më parë nga ERE, me numër dhe datë protokolli ose referencë të dosjes: _____.
8. Regjistrat publikë ku ERE mund të verifikojë të dhënat e aplikuesit: emërtimi i regjistrit dhe identifikuesi përkatës: _____.
9. Deklaroj se të dhënat e paraqitura janë të sakta dhe dokumentet janë autentike; çdo ndryshim në të dhënat e aplikimit do t'i njoftohet ERE-s gjatë shqyrtimit.
10. Data: _____;
    emri, mbiemri dhe cilësia e nënshkruesit: _____;
    nënshkrimi: _____.

ANEKSI 2 – DOKUMENTACIONI PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR CENTRALET E LIDHURA NË RRJETIN E SHPËRNDARJES

1. Formulari i plotësuar sipas Aneksit 1.

2. Akti i miratimit/autorizimit të ndërtimit ose zhvillimit të kapacitetit prodhues, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi.

3. Dëshmi penaliteti (lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) për shoqërinë aplikuese dhe administratorin/administratorët.

4. Vërtetime për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve tatimore dhe atyre të sigurimeve shoqërore.

5. Dokumenti i miratimit të lidhjes ose marrëveshja përkatëse me operatorin e sistemit të shpërndarjes, që identifikon impiantin, pikën e lidhjes dhe fuqinë e miratuar.

6. Dokumenti që vërteton të drejtën e pronësisë ose të përdorimit të impiantit (sipas aktit përkatës, miratimi i lëshuar nga ministri përgjegjës për energjinë ose Këshilli i Ministrave, akti i privatizimit apo dokumentacioni përkatës që provon kalimin e së drejtës së pronësisë etj.),

7. Lejet ose miratimet mjedisore dhe të përdorimit të burimeve ujore, vetëm kur kërkohen për impiantin konkret nga legjislacioni në fuqi.

8. Për impiantet e përfunduara, aktet e testimit dhe kolaudimit, kur këto janë të detyrueshme.

9. Pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit, kur këto të fundit kërkohen nga legjislacioni në fuqi, dokumentacionin që vërteton burimet e financimit, planin e biznesit, ose dokumente të tjera që provojnë aftësinë dhe kapacitetin financiar për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkohet licenca. Dokumentacioni duhet të jetë në përputhje me natyrën, përmasat dhe kërkesat financiare të veprimtarisë përkatëse.

10. Kur impianti ndodhet në fazën përfundimtare të ndërtimit, aplikuesi paraqet informacion mbi ecurinë dhe nivelin e realizimit të investimit, të shoqëruar me kopje të informacioneve dhe raportimeve të paraqitura pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë lidhur me realizimin e investimit dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga autorizimi ose akti përkatës i miratimit.

11. Deklarata e saktësisë së të dhënave dhe dëshmia e pagesës së tarifës së aplikimit.

ANEKSI 3 – DOKUMENTACIONI PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E OPERIMIT TË IMPIANTEVE TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRKE TË LIDHURA NË RRJETIN E SHPËRNDARJES

1. Formulari i plotësuar sipas Aneksit 1.

2. Dëshmi penaliteti (lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) për shoqërinë aplikuese dhe administratorin/administratorët.

3. Vërtetime për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve tatimore dhe atyre të sigurimeve shoqërore

4. Akti i autorizimit ose miratimit të impiantit, kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

5. Miratimi i lidhjes me rrjetin dhe marrëveshjen përkatëse me operatorin e sistemit, sipas rastit;

6. Dokumenti që vërteton të drejtën e pronësisë ose të përdorimit të impiantit (sipas aktit përkatës, miratimi i lëshuar nga ministri përgjegjës për energjinë ose Këshilli i Ministrave, akti i privatizimit apo dokumentacioni përkatës që provon kalimin e së drejtës së pronësisë etj.),

7. Rregullore të brendshme per sigurinë elektrike, për mbrojtjen nga zjarri dhe reagimin ndaj emergjencave, si dhe lejet mjedisore, kur kërkohen nga legjislacioni në fuqi.

8. Për impiantet në operim: aktet e testimit dhe kolaudimit, kur kërkohen, si dhe dokumenti ku operatori i rrjetit konfirmon përmbushjen e kushteve teknike të lidhjes.

9. Pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit, kur këto të fundit kërkohen nga legjislacioni në fuqi, dokumentacionin që vërteton burimet e financimit, planin e biznesit, ose dokumente të tjera që provojnë aftësinë dhe kapacitetin financiar për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkohet licenca. Dokumentacioni duhet të jetë në përputhje me natyrën, përmasat dhe kërkesat financiare të veprimtarisë përkatëse.

10. Kur impianti ndodhet në fazën përfundimtare të ndërtimit, aplikuesi paraqet informacion mbi ecurinë dhe nivelin e realizimit të investimit, të shoqëruar me kopje të informacioneve dhe raportimeve të paraqitura pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë lidhur me realizimin e investimit dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga autorizimi ose akti përkatës i miratimit

11. Deklarata e saktësisë së të dhënave dhe dëshmia e pagesës së tarifës së aplikimit.

ANEKSI 4 – DOKUMENTACIONI PËR LICENCIMIN NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

1. Formulari i plotësuar sipas Aneksit 1.

2. Dëshmi penaliteti (lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) për shoqërinë aplikuese dhe administratorin/administratorët.

3. Vërtetime për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve tatimore dhe atyre të sigurimeve shoqërore

4. Përshkrimi i modelit të tregtimit, tregjeve ku synohet të operohet dhe vëllimeve të parashikuara të blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike.

5. Informacioni për organizimin e veprimtarisë dhe personin përgjegjës për transaksionet.

6. Plani biznesi për ushtrimin e veprimtarisë, ku të jenë parashikuar kostot dhe të ardhurat përkatëse, si dhe mënyra e financimit të veprimtarisë.

7. Pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit, kur këto të fundit kërkohen nga legjislacioni në fuqi, dokumentacionin që vërteton burimet e financimit, planin e biznesit, ose dokumente të tjera që provojnë aftësinë dhe kapacitetin financiar për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkohet licenca. Dokumentacioni duhet të jetë në përputhje me natyrën, përmasat dhe kërkesat financiare të veprimtarisë përkatëse (*mbështetja financiare duhet të garantojë të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi dhe përllogaritjes që do të bëhet duke marrë për bazë çmimin mujor të Ditës në Avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, ALPEX, që i korrespondon muajit që i paraprin datës së aplikimit).*

8. Deklarata e saktësisë së të dhënave dhe dëshmia e pagesës së tarifës së aplikimit.

ANEKSI 5 – DOKUMENTACIONI PËR LICENCIME VEPRIMTARINË E DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR SUBJEKTET QË KANË PËRFITUAR NGA REGJIMI KALIMTAR

1. Formulari i aplikimit sipas Aneksit 1, me identifikimin e operatorit, impiantit dhe numrit të regjistrimit ose dosjes së mëparshme pranë ERE-s.

2. Dëshmi penaliteti (lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) për shoqërinë aplikuese dhe administratorin/administratorët.

3. Vërtetime për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve tatimore dhe atyre të sigurimeve shoqërore.

4. Deklarata e përditësimit të të dhënave të regjistrimit, me identifikimin e dokumenteve të pandryshuara dhe të ndryshimeve të ndodhura.

5. Akti i autorizimit ose miratimit për impiantin, kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi dhe nuk është administruar më parë i vlefshëm në dosje.

6. Dokumenti i miratimit ose i kushteve të lidhjes me rrjetin dhe çdo ndryshim i tij pas regjistrimit.

7. Rregullore të brendshme për sigurinë elektrike, për mbrojtjen nga zjarri dhe reagimin ndaj emergjencave, si dhe lejet mjedisore, kur kërkohen nga legjislacioni në fuqi.

8. Për impiantet në operim: aktet e testimit dhe kolaudimit, kur kërkohen nga legjislacioni në fuqi, dhe dokumenti ku operatori i rrjetit konfirmon përmbushjen e kushteve teknike të lidhjes.

9. Pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit, kur këto të fundit kërkohen nga legjislacioni në fuqi, dokumentacionin që vërteton burimet e financimit, planin e biznesit, ose dokumente të tjera që provojnë aftësinë dhe kapacitetin financiar për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkohet licenca. Dokumentacioni duhet të jetë në përputhje me natyrën, përmasat dhe kërkesat financiare të veprimtarisë përkatëse.

10. Dëshmia e pagesës së tarifës së aplikimit sipas aktit tarifor në fuqi.

Dokumentet e disponueshme dhe të vlefshme në dosjet e mëparshme të ERE-s nuk riparaqiten. Të dhënat që ERE mund t’i verifikojë ligjërisht në regjistra publikë nuk kërkohen me dokument të veçantë. Aplikuesi identifikon dokumentin ose regjistrin sipas formularit të Aneksit 1. Këto rregulla nuk zëvendësojnë autorizimet, lejet dhe kushtet ligjore të detyrueshme për ushtrimin e veprimtarisë.